



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

Kom.Dh.Shk.II.nr.103/23

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS - Dhomat e shkallës së dytë, gjyqtari Krenar Berisha, në çështjen juridike përmbarimore të kreditorit Komisioni i Pavarur i Mediave, me seli në Prishtinë, rr. “Perandori Justinian”, nr.124, kundër debitorit Radio Kosova 2 me seli në Prishtinë rr. Nëna Terezë me drejtor A.B., të cilin me autorizim e përfaqëson SH.S., duke vendosur lidhur me ankesën e debitorit, të paraqitur kundër aktvendimit të Gjykatës Themelore në Prishtinë – Departamenti i Përgjithshëm, PPP.nr.346/2021, i datës 21.07.2021, me datë 05.07.2023, mori këtë:

A K T V E N D I M

APROVOHET ankesa e debitorit Radio Kosova 2 me seli në Prishtinë, NDRYSHOHET aktvendimi i Gjykatës Themelore në Prishtinë – Departamenti i Përgjithshëm, PPP.nr.346/2021, i datës 21.07.2021, ashtu që çështja gjykohet si në vijim:

APROVOHET si i bazuar prapësimi i debitorit Radio Kosova 2 me seli në Prishtinë, i ushtruar kundër Urdhrit mbi lejimin e përmbarimit P.nr.541/18 dt.02.02.2018, ANULOHET Urdhri përmbarimor P.nr.541/18 dt.02.02.2018 i Përmbaruesit Privat Destan Bujupaj në Prishtinë.

A r s y e t i m

Gjykata Themelore në Prishtinë – Departamenti i Përgjithshëm, me aktvendimin e atakuar PPP.nr.346/21 të datës 21.07.2021, e ka Refuzuar si të pabazuar prapësimin e debitorit të ushtruar kundër urdhrin për lejimin e përmbarimit P.nr.541/18 të datës 02.02.2018, të lejuar nga Përmbaruesi Privat Destan Bujupaj.

Kundër këtij aktvendimi në afatin ligjor ka ushtruar ankesë debitorit Radio Kosova 2 me seli në Prishtinë, për shkak të shkeljes esenciale të dispozitave të procedurës përmbarimore, konstatimit të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes dhe zbatimit të gabuar të drejtës materiale, me propozimin që të anulohet aktvendimi i atakuar dhe urdhri përmbarimor.

Gjykata Komerciale – Dhomat e shkallës së dytë, i shqyrtoi shkresat e lëndës, aktvendimin e atakuar dhe pretendimet ankimore, në kuptim të nenit 3 par.2 të Ligjit nr.04/L-139 për Procedurën Përmbarimore (LPP), si dhe në kuptim të nenit 194 të Ligjit për Procedurën Kontestimore (LPK), gjeti se:

Ankesa e debitorit është e bazuar.

Nga shkresat e lëndës rrjedh se kreditori Komisioni i Pavarur i Mediave, me seli në Prishtinë, me datën 01.02.2018 ka paraqitur propozim për lejimin e përmbarimit, kundër debitorit Radio Kosova 2 në Prishtinë, në bazë të dokumentit të besueshëm – Faturës nr.001544 datës 31.01.2017 për shumën e borxhit prej 5,600.00 €.

Përmbaruesi Privat Destan Bujupaj, me seli në Prishtinë, duke vepruar sipas propozimit të kreditorit Komisioni i Pavarur i Mediave ka caktuar urdhrin P.nr.5419/18 të datës 02.02.2018, duke lejuar përmbarimin në bazë të dokumentit të besueshëm Faturës nr.001544 të datës 31.01.2017, me të cilin e ka urdhëruar debitorin Radio Kosova 2, që të ia paguaj kreditorit në emër të borxhit të përcaktuar sipas faturës shumën prej 5.600.00€ € si dhe shpenzimet e procedurës përmbarimore në pajtim me Udhëzimin Administrativ UA-MD Nr.06/2014, nën kërcënimin të përmbarimit të dhunshëm dhe pasojave tjera ligjore.

Gjykata Themelore në Prishtinë – Departamenti i Përgjithshëm, në rivendosje, me aktvendimin e atakuar PPP.nr.346/21 të datës 21.07.2021, e ka Refuzuar si të pabazuar prapësimin e debitorit të ushtruar kundër urdhrin për lejimin e përmbarimit P.nr.541/18 të datës 02.02.2018, të lejuar nga Përmbaruesi Privat Destan Bujupaj. Në arsyetim të aktvendimit të atakuar gjykata ka theksuar se fatura nr. 001544, e datës 31.01.2017, në bazë të së cilës është lejuar urdhri për përmbarim, është dokument përmbarues dhe parqet bazë për caktimin e përmbarimit ngase i ka plotësuar kushtet ligjore nga neni 24 dhe 27 i LPP-së.

Nga një vërtetim i tillë i gabuar i gjendjes faktike nga neni 183 të LPK-së, nga gjykata e shkallës së parë, e cila fare nuk është lëshuar në elementet vendimtare të faturës nr.0127 dt.21.12.2018, Dhomat e Shkallës së Dytë, vlerësoi se për shkak të konstatimit të gabuar të gjendjes faktike, në rastin konkret nuk është aplikuar drejt ligji, sepse nuk kemi një dokument të besueshëm dhe të përshtatshëm që i plotëson kushtet ligjore nga neni 21 dhe 29 të LPP-së. Dhomat e Shkallës së Dytë, vlerësoi se në shkresat e lëndës nuk ka prova se kjo faturë e lëshuar nga kreditori, është e nënshkruar apo pranuar nga debitori.

Nisur nga kjo gjendje e çështjes, Gjykata Komerciale – Dhomat e shkallës së dytë, vlerëson se gjykata e shkallës së parë, edhe përkundrejt vërejtjeve nga gjykata e Apelit me aktvendimin Ac.nr.5597/20 dt.11.02.2021, në rivendosje, nuk i ka marrë për bazë rekomandimet për të vlerësuar se fatura nr.001544 dt.31.01.2017, a mund të trajtohet si dokument i besueshëm dhe i përshtatshëm për përmbarim në kuptim të dispozitës së nenit 29 paragrafi 3 i LPP-së. Dhomat e shkallës së dytë mbi bazën e kësaj dispozite ligjore vlerëson se gjykata e shkallës së parë nuk ka vepruar drejtë kur ka nxjerr konstatimin e gjendjes faktike, se fatura e lëshuar nga ana e kreditorit është dokument i besueshëm mbi të cilën ishte iniciuar procedura përmbarimore.

Udhëzimi administrativ nr.15/2010 par Zbatimin e Ligjit nr.03/L-222 për Administratën Tatimore dhe Procedurat, neni 20 par.1 nënpar.1.17 parasheh që: *“Në minimum, një faturë duhet të jetë e nënshkruar nga shitësi, nëse klienti apo blerësi është dispozicion për të nënshkruar, ai person*

duhet po ashtu të nënshkruajë faturën tatimore”, e që në rastin konkret fatura për të cilën kreditori kërkon përmbushjen e detyrimit, nuk ka prova se është e pranuar nga debitori, e njëjta nuk është e vulosur nga ana e tij, në mënyrë që të konsiderohet si dokument i besueshëm.

Andaj, Dhomat e shkallës së dytë, nuk e ka pranuar si të drejtë përfundimin e gjykatës së shkallës së parë se fatura e kreditorit është dokument i besueshëm i lejuar për përmbarim. Nga këto arsye, Gjykata Komerciale –Dhomat e Shkallës së Dytë, vlerëson ndryshe gjendjen faktike dhe zbatimin e të drejtës materiale dhe gjen se në rastin konkret plotësohen kushtet ligjore që aktvendimi i ankimuar të ndryshohet, Pranohet si i bazuar prapësimi i debitorit Radio Kosova 2 me seli në Prishtinë, i ushtruar kundër Urdhrit mbi lejimin e përmbarimit P.nr.541/18 dt.02.02.2018, dhe Anullohet Urdhri përmbarimor P.nr.541/18 dt.02.02.2018 i Përmbaruesit Privat Destan Bujupaj në Prishtinë.

Gjykata Komerciale - Dhomat e shkallës së dytë, duke shqyrtuar pretendimet ankimore, vlerëson se janë tërësisht të qëndrueshme. KPM- si kreditor, e ka licencuar debitorin për ofrim të shërbimit audio në Republikën e Kosovës, i cili me nënshkrimin e kushteve dhe termeve të përgjithshme të licencës së KPM-së dhe duke u bazuar në Ligjin Nr.04/L-44 për Komisionin e Pavarur të Mediave, obligohet të bëj pagesën e tarifës për licencë çdo vit kalendarik. Megjithatë, kjo gjykatë sqaron se ekzekutimi i detyrimeve monetare nga subjektet e ndryshme juridike në procedurën përmbarimore, pavarësisht statusit të tyre dhe objektit të përmbarimit (i.e. qofshin ato licenca apo borxhe afariste), i nënshtrohet shqyrtimit juridik-formal të dokumentit përmbarimor apo atij të besueshëm mbi bazën e të cilit është lejuar përmbarimi.

Së këndejmi, Dhomat e shkallës së dytë, është e qëndrimit juridik se në procedurën përmbarimore organi përmbarues, përfshirë këtu edhe gjykatën që ka kompetencë shqyrtimin e ligjshmërisë së përmbarimit, nuk ka tagër të vlerësojë ligjshmërinë e raportit juridik nga i cili rrjedh dokumenti i besueshëm, statusin e palëve apo detyrimet e ndërsjella mes tyre. Por, organi përmbarues, përfshirë edhe gjykatën e shkallës së parë shqyrton vetëm rregullsinë dhe përshtatshmërinë e dokumentit përmbarues dhe/apo atij të besueshëm, me ç’rast procedura sipas prapësimit i nënshtrohet vetëm shqyrtimit formal të titullit ekzekutiv. Fakti se kreditori është organizatë buxhetore dhe autoritet rregullativ në fushën e mediave, është evidente se ka të drejtë për të arkëtuar pagesat e tarifës për licenca qoftë përmes faturave apo edhe akteve të veta administrative. Mirëpo, hyrja në raport juridik me palët debitore dhe inicimi i procedurës përmbarimore nuk nënkupton se mund të anashkalohen prerogativat ligjore të parapara me dispozitat e nenit 29 par.3 të LPP-së.

Andaj, duke marr parasysh pretendimet ankimore, të cilat konsistojnë ndaj aktvendimit të ankimuar, Gjykata Komerciale e Kosovës - Dhomat e Shkallës së Dytë konsideron se këto pretendimet ankimore janë të bazuara, ngase kemi të bëjmë me shkelje thelbësore të dispozitave të Ligjit të Procedurës Kontestimore, dhe zbatimin të gabuar të se drejtës materiale, të cilat shkelje kjo gjykatë i vështron sipas detyrës zyrtare në kuptim të nenit 194 të LPK-së, dhe të Ligjit të Procedurës Përmbarimore.

Nga sa u tha me lartë u vendos si në dispozitiv të këtij aktvendimi në kuptim të nenit 209 pika c) të LPK-së.

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS

Dhomat e shkallës së dytë

Kom.Dh.Shk.II.nr.103/23 dt. 05.07.2023

Gjyqtari,
Krenar Berisha